



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHES SPANJOLLE

Titulli i kursit: Gjuhë e Praktike e Gjuhës B (1)

Titullari / pedagogu i lëndës: Dr. Viola Biti (Gjyli)

Ngarkesa: 12 (dymbëdhjetë) kredite; 120 orë (120 seminare)

Viti akademik : Viti 1/ semestri 1

Lloji i lëndës: e detyrueshme

Programi i studimit: cikli i parë; dega: Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim hispanik

Adresa elektronike e titullarit / e pedagogut të lëndës: viola.bit@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat lëndore:

Studenti të jetë i aftë të ndërveprojë përmes kompetencës komunikuese që ofron Niveli A (1,2) dhe B (1, 2) i përshkruar në MCER (Manuali i përbashkët i referencës për gjuhët e huaja).

Studenti të jetë i aftë të përvetësojë koncepte bazike të gramatikës, drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit, të fjalorit. Të shprehet në formë gojore dhe të shkruar thelbësore në gjuhën spanjolle; të përshkruajë vende dhe njerëz; të redaktojë një biografi; të kryejë komentare të shkurtër mbi tema të ndryshme; të punojë në grup dhe të bashkëpunojë me persona të tjerë; të kryejë dhe të përmbushë veprimtari; të organizojë, planifikojë dhe të përdorë informacionin në gjuhë të huaj; të njohë tradita dhe kulturë nga popujt hispanikë; të vetëvlerësohet dhe të vlerësojë të tjerët;

Rezultatet e nxënësve:

Eshtë një lëndë e detyrueshme, e cila ofrohet si formim bazik gjuhësor për studentët e gjuhës spanjolle në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. aftësi për një komunikim bazë me gojë dhe me shkrim në gjuhën spanjolle; Ne perfundim të kësaj lende studenti duhet të arrijë:

- Aftësi për të kuptuar dhe interpretuar në mënyrë morfo-sintaksore tekste në spanjisht;
- Aftësi për të përvetësuar koncepte bazike të gramatikës, drejtshkrimit, fjalorit;
- Aftësi për të dialoguar me persona; njohja e zakoneve dhe traditave në harkun

kulturor hispanik;

- aftësine për të qenë kreativë, për të arsyetuar në mënyrë kritike dhe auto-kritike;
- aftësine për të organizuar, planifikuar dhe për të përcjellë informacionin në auditor;